

**VENDIM**  
**Nr. 254, datë 10.4.2026**

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË NEGOCIMIT TË SHOQËRISË SHTETËRORE  
“KAYO” SHA, ME SHOQËRI PRIVATE PËR KRIJIMIN  
E NJË SHOQËRIE TË PËRBASHKËT PËR PRODHIMIN, MONTIMIN, RIPARIMIN  
DHE TREGTIMIN E MJETEVE FLUTURUESE PA PILOT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ky vendim ka për objekt miratimin e kushteve të negociimit të shoqërisë “KAYO” sh.a., me shoqëri private, me qëllim krijimin e një shoqërie aksionare të përbashkët për prodhimin, montimin, riparimin dhe tregtimin e mjeteve fluturuese pa pilot, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Shoqëria “KAYO” sh.a. do të negociojë dhe do të pranojë një pjesëmarrje jo më të ulët se 25% të aksioneve në shoqërinë e përbashkët, që do të krijojë me shoqëri private.

3. Shoqëria “KAYO” sh.a. do të kontribuojë në entitetin e ri tregtar me pasuri të paluajtshme, në masën jo më pak se 1 000 m<sup>2</sup>, që do të jepen në përdorim shoqërisë së përbashkët, në një nga format e parashikuara nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, pa të drejtë tjetërsimi.

4. Shoqëria “KAYO” sh.a., gjatë procesit të negociimit, në çdo rast siguron nga subjekti, me të cilin negocion, minimalisht:

- a) një vlerë investimi jo më të ulët se 30 milionë euro në harkun kohor të 3 (tre) vjetëve;
- b) punësimin e jo më pak se 35 punonjësve në harkun kohor të 3 (tre) vjetëve;
- c) ofrimin e linjave teknologjike të prodhimit të mjeteve fluturuese pa pilot;
- ç) sigurimin e rrjetit të shpërndarjes së produkteve në rast eksporti.

5. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave se, përpos parashikimeve të tjera, objekti i aktivitetit të shoqërisë tregtare, që do të krijohet, do të përmbajë montimin, prodhimin, riparimin dhe tregtimin e mjeteve fluturuese pa pilot.

6. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave se administratori/ët e shoqërisë, që do të krijohet nga dy shoqëritë e sipërpërmendura, zgjidhet me dakordërsinë e shoqërisë “KAYO” sh.a.

7. Shoqëria “KAYO” sh.a. siguron nga pala tjetër gjatë negociatave se minimalisht 30% të këshillit drejtues ose këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, që do të krijohet, në rast se forma e shoqërisë parashikon këto organe drejtuese/mbikëqyrëse, do të emërohen nga shoqëria “KAYO” sh.a.

8. Statuti i shoqërisë, që do të krijohet, përmban dispozitat për të drejtën e vetos, që gëzon shoqëria “KAYO” sh.a. në bazë të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

9. Siguria fizike e personelit dhe e infrastrukturës do të sigurohet nga Forcat e Armatosura, sipas akteve nënligjore, të dala nga autoritetet kompetente sipas ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Ngarkohet shoqëria shtetërore “KAYO” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**